



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:085400

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05675494

C.nr.1113/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Agron Karatash, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestuese të inicuar me padi nga ana e paditëses V.M. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson Studio Ligjore & Financiare “Klinaku” me avokatët nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtave (ushqimit), me vlerë të kontestit 292.00 (dyqind e nëntëdhjetë e dy) euro, me datë 13.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses V.M. nga Prizreni dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses, në emër të shujtave ditore për **146 ditë** pune gjatë periudhës kohore nga data 01.01.2022 deri më 21.11.2022, t’ia kompensoj shumën e përgjithshme prej **292.00 (dyqind e nëntëdhjetë e dy) euro**, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë me datë 07.04.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura, që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej **124.00 (njëqind e njëzet e katër) euro**, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja V.M. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj Studio Ligjore & Financiare “Klinaku” me avokatët nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datë 07.04.2023, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit me të cilën ka kërkuar që e paditura t’ia bëjë kompensimin e ushqimit (shujtave) për ditët e pranisë në punë prej datës 01.01.2022 deri më 31.12.2022, të cilën padi e ka precizuar me parashtrësën e datës 19.03.2024, me të cilën tani ka kërkuar kompensimin e ushqimit gjatë ditëve të pranisë

në punë për periudhën kohore prej datës 01.01.2022 deri me datën 21.11.2022, për 146 ditë pune.

Në referatin e padisë autorizuari i paditëses ka theksuar paditësja është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura në vendin e punës si mësimdhënëse në SH.F.M.U. “Abdyl Frashëri” në Prizren. E paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) edhe përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të të drejtave të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e nënshkruar më 18.04.2017 dhe 22.01.2021, në mes të palëve në marrëveshje si, për SBASHK, për të punësuarin Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës dhe për Qeverinë e Kosovës/ Ministria e Arsimit, konform dispozitave të nenit 35 para. 7 të marrëveshjes së cekur, Ligjit të Punës (nenet 4, 10, 11, 55, 90) dhe Kontratës individuale nuk ka bërë kompensimin e shujtave (ushqimit) për ditët e pranisë në punë nga 2 (euro) në ditë. Në fund thekson se Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) është e obliguar që në bazë të fitimit të drejtës së paditëses t’ia paguajë kompensimin për shujta ditore për ditët e pranisë në punë për një ditë pune nga 2 (dy) euro, e cila shumëzohet me ditët e pranisë në punë. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e vet konform dispozitave (obligative) të Kontratës Kolektive të Arsimit (më konkretisht nenit 35 para.7), Ligjit të Punës (nenet 4, 10, 11, 55, 90) dhe kontratës individuale, andaj ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditëses. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses. Ka se theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/488 të datës 21.11.2022 për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar, pretendimet e paditëses se i takon kompensimi deri më 21.11.2022 janë të pa bazuara për arsye se në mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.214/2023, e datës 05.10.2023, rastet e të punësuarve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, duhet trajtuar deri me datë 21.11.2022, kur kjo kontratë është shkëputur nga njëra prej palëve kontraktuese. Më tej ka theksuar se paditësja nuk ka ofruar prova që është anëtare e sindikatës dhe i ka kaluar procedurat administrative sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës dhe nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, po ashtu me këto veprime i shkakton Komunës së Prizrenit shpenzime të mëdha, sepse e obligon që t’ia paguajë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Po ashtu thekson se në mungesë të alokimit të mjeteve nga Ministria e Arsimit, e paditura nuk mund të veprojnë në kundërshtim me planifikimin buxhetor. Në fund ka theksuar se pretendimet e paditëses janë në kundërshtim me nenin 90 para.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarave, dhe në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënëse dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate, andaj nga të gjitha të cekurat ka kërkuar që gjykata të nxjerr aktgjykim dhe të refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në SH.F.M.U. “Abdyl Frashëri” në Prizren, e cila bie në kompetencë të paditurës.

Gjykata përmes kontratës së punës për mësimdhënës me numër të protokollit 326/3, e datës 07.10.2019, ka vërtetuar faktin se paditësja ka krijuar marrëdhënie pune më të paditurën në SH.F.M.U. “Abdyl Frashëri”, në Prizren në vendin e punës Mësimdhënëse klasore.

Nga vërtetimi me numër të protokollit 408/52 e datës 07.11.2023, të lëshuar nga ana e të paditurës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja V.M. nga data 01.01.2022 deri më 21.11.2022, ka qenë prezent në punë 146 ditë pune.

Kontratën dhe vërtetimin e lartcekur, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndër marrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj meqë ky dokument është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat edhe si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimet e lëshuara nga ana e SH.F.M.U. “Abdyl Frashëri”, në Prizren, si provë me të cilat vërtetohet fakti lidhur me ditët e prezencës në punë të paditëses, gjykata ia fali besimin e plotë, e nga të cila vërtetoi faktin se për 146 ditë nga data 01.01.2022 deri me datën 21.11.2022, paditësja ka qenë në vendin punës.

Me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, e më saktësisht në dispozitivin 35 paragrafi 7, të KKAK-së është paraparë se “*Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim*”.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditëses si mësimdhënëse t’ia paguaj kompensimin për ushqimin gjatë punës, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht ditët e punës për paditësen, të vërtetuara nga vet punëdhënësi, për 146 ditë prezent në punë, gjykata i ka shumëzuar me shumën prej 2 euro të parapara si në nenin 35 paragrafi 7 të KKAK-së, duke ia njohur shumën e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që “*po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet*

vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”.

Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 152 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëses është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritore.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë me datë 07.04.2023, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së lidhur me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve e datës 18 mars 2017, lartësia e shpenzimeve i referohet 104.00 euro për përpilimin e padisë, si dhe për taksën gjyqësore shumën prej 20.00 euro, gjithsej shumën prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:085400, 13.05.2024

B.profesional
Ali Kosova

Gjyqtari
Agron Karatah

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.